

**NJOFTIM/SHPALLJE E PROCEDURËS SË KONKURIMIT PËR EMERIMIN NË
POZICIONIN E PUNËS “PUNONJËS SHERBIMI”,
NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM FIER**

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 74, 75, 76, e vijues, të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimi e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 19, datë 30.01.2024, “Për caktimin e strukturës organike të Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllim plotësimin e vendit vakant sipas strukturës organike të institucionit, të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm, dërguar me shkresën nr. 160/4, datë 31.01.2024, të Sekretarit të Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, shpall fillimin e procedurën për emërimin në pozicionin:

- 1 (një) vend për pozicionin “Punonjës Shërbimi” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, kategoria e pagës I (VKM 326).

Afati për dorëzimin e dokumentave është deri në 30.12.2024

I. PËRSHKRIMI PËRGJITHËSUES I PUNËS

-
- Të zbatojë me përpikmëri sigurimin e rregullit të brendshëm dhe ruajtjen e rendit në ambientet e Prokurorisë me mbështetjen e e punonjësit të Policisë së Ruajtjes Fizike;
 - Të kërkojë nga i gjithë personeli zbatimin e rregullit dhe ruajtjen e rendit në ambientet e Prokurorisë;
 - Të lejojë hyrjen për nevoja pune e shërbimi, apo takime me punonjës të insitucionit të personave të jashtëm, vetëm pas njoftimit të punonjësit dhe shoqërimit prej tyre të qytetarëve;
 - Të regjistrojë në regjistrin përkatës emrin e personit të jashtëm, orën e hyrjes dhe emrin e pritësit;
 - Të kërkojë nga personat e jashtëm kalimin në aparaturën e kontrollit;
 - Të mbajë armën (në rast se kanë) duke bërë regjistrimin përkatës të numrit të saj në regjistër dhe kthimin pas takimit;
 - Të komunikojë me sektorët përkatës për ankesat që kanë bërë qytetarët duke i sqaruar ata vetëm sipas përgjigjes së marrë nga zyrat përkatëse, pa dhënë mendime e shpjegime personale;
 - T’u kërkojë personave që paraqiten për takim një dokument identifikimi, ti pajisë me fletëhyrje, dhe në përfundim të takimit, t’u kthejë dokumentin e identifikimit;
 - Të zbatojë me përpikmëri orarin e shërbimit;

- Të bashëkpunojë me punonjësit e ruajtjes së objektit për zbatimin me korrektësi të kërkesave të rregullores së brendshme dhe kërkesave specifike të sigurimit fizik të objektit;
- Të zbatojë me përpikmëri grafikun e shërbimit dhe rregullat e marrjes dhe dorëzimit të tij;
- Të mos lërë për asnjë moment vetëm vendin e shërbimit;
- Të jetë i kujdesshëm me qytetarët dhe në rast konflikti të njoftojë kancelarin (kryesekretarin deri në plotësimin e vendit të kancelarit) dhe kur gjykon se po çënohet rendi në institucion. kërkon ndihmën e punonjësit të policisë;
- Të zbatojë detyrat specifike të dhëna nga eprorët për situata të ndryshme si festa, pushime apo situata gadishmërie;
- Në rast fatkeqësish natyrore, si zjarr, përmytje, ndonjë difekt i rëndë elektrik, etj., njofton zjarfikësen, drejtuesin, kancelarin, kryesekretarin, mirëmbajtësin dhe vepron me iniciativë me fikësat apo hidrantët e ujit për mospërhapjen e rrezikut;
- Të kujdeset për mbarëvajtjen e punës, referuar rregullave të etikës profesionale dhe të sjelljes korrekte;
- Kryen funksione të tjera të caktuara me ligj, akte nënligjore, si dhe zbaton urdhëra të tjera të dhënga nga drejtuesi dhe/ose kancelari i prokurorisë.

II. KUSHTET E PËRGJITHSHME QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI DHE KRITERET E VEÇANTA.

II.1. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme për pranim si vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kundrvajtjeje penale me dashje, si dhe të mos jetë nën hetim (ndjekje penale);
- Të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil apo administrata shtetërore që nuk është shuar sipas këtij ligji, si dhe të mos ketë asnjë masë tjetër disiplinore të fuqi;
- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm apo të lartë;

II.2 Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të ketë përvojë pune, mundësisht të lidhur me insitucionet e drejtësisë apo me rregullin dhe sigurinë.
- Të plotësojë kriteret ligjore për pajisjen me Certifikatë të Sigurimit të Personelit nga DSIK.

III. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht me postë ose dorazi në kryesekretari, brenda datës 30.12.2024, ora 10⁰⁰, në adresën: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Lagjia “29 Nëntori”, Rruga: “Todi Shkurta”, Fier, ose elektronikisht në adresën e email: Eni.Begaj@pp.gov.al, kopje të dokumenteve si më poshtë:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron;
- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- Fotokopje e diplomës së shkollës së mesme apo/dhe të shkollës së lartë (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njësimi nga MAS),si dhe liste notash, të njësuara me origjinalin nga noteri;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja;
- Dokument që nuk ka masë disiplinore në fuqi (dokument nga institucioni), vertetim se ndaj tij/saj nuk është marrë masë disiplinore në marredhënie pune dhe /ose ndonjë masë tjetër disiplinore dhe/ose nëse është marrë, document që vërtetojnë se masa është shuar;
- Vlerësimin e fundit të rezultateve në punë të dhëna nga titullari i insitucionit përkatës;
- Fotokopje të çertifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Dëshmi penaliteti dhe Vetëdeklarim për vërtetimin e gjendjes gjyqësore, sipas linkut <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/formulari-i-vetdeklarimit-gjendja-gjyqesore.pdf>
- Vërtetim i gjendjes shëndetësore, për gjëndjen shëndetësore i afte për punë;
- Dokumentacion tjetër, mbi trajnimet, kualifikimet (nëse ka);
- Dëshmi të njohurive të gjuhës së huaja nëse ka;
- Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës;
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit;
- Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ka çështje në proces;
- Vërtetim nga përmbartimi gjyqësor;
- Certifikatë të Sigurimit të Personelit (nëse ka).

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara sjell skualifikimin e kandidatit.

Verifikimi paraprak i përmbushjes së kushteve të përgjithshme dhe kritereve të veçanta në shpalljen për konkurrim, do të kryhet pas orës 10⁰⁰, të datës 30.12.2024 dhe do të shpallet lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, të shpalljes për konkurrim.

Kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, do të njoftohen nëpërmjet adresës së e-mail të dhëna prej tyre, për shkaqet e moskualifikimit.

Shpallja do të bëhet në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë dhe në ambientet e jashtme të njoftimeve të Prokurorisë Fier.

IV. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen mbi bazën e dokumenteve, në lidhje me jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, etj, të lidhura me fushën dhe detyrat e punonjësit të shërbimit, deri në 100 pikë.

Mënyra e vlerësimit do të kryhet sipas ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

V. REZULTATE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Prokuroria Fier do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet nëpërmjet adresës së e-mail-it të dhënë prej tyre. Prokuroria Fier do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Prokurorisë dhe në ambientet e jashtme të njoftimeve të Prokurorisë Fier.

Fier, më datë 16 .12.2024

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM FIER**